

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI

### I

Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar

**“AGROTURIZEM NDRYSHE ” shpk**

Në Tiranë, sot më datë 11 Shtator 2023, në cilësinë e ortakëve themelues,

**Fondacioni “Fundjavë Ndryshe”, organizatë jofitimprurëse, e organizuar dhe themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, themeluar sipas Vendimit të Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 534, datë 01.12.2015, me seli në Rruga e Arbërit, e regjistruar pranë organeve tatimore, me NUIS L61315453U, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Z. Arbër Hajdari, shtetas shqiptar, lindur më 16.02.1994, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032471820, dhe me numër personal J40216055N madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu në vijim referuar si “Fondacioni”);**

I cili në cilësinë e “ortakut themelues”, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, hartoj këtë akt themelimi dhe statut për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“AGROTURIZEM NDRYSHE ”** shpk mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” të ndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723, datë 3.5.2007, “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit” në Kodin Doganor, e ligjin 9920 dt 19.05.2008 i ndryshuar, për procedurat tatimore në rep.e shqipërisë.

### KREU I

#### **Neni 1**

**Krijimi .**

Shoqëria **“AGROTURIZEM NDRYSHE ”** shpk është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur ”Shoqëria”). **Emri tregtar i shoqërisë “AGROTURIZEM NDRYSHE ”** shpk

#### **Neni 2**

Personaliteti juridik.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtët dhe procedurat e parashikuara më ligj.

Shoqëria "AGROTURIZEM NDRYSHE " shpk , është një shoqëri tregtare e themeluar nga ortakut i shoqërisë Fondacioni "Fundjave Ndryshe", i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

### **Neni 3**

Selia.

**Shoqëria e ka selinë kryesore në Brar, Tiranë. Zona Kadastrale 1263. Nr Pasuris 969/12,objekti nr 14.** Shoqëria mund të ndryshojë seline e tij, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të Ortakut të Shoqërisë.

### **Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë.**

**4.1 Agro-Turizëm. Restorant. Organizim Evente**

**4.2** Aktivitete të agroturizmit dhe zhvillim rural, dhe të ngjashme, merr, trajton, ruan, magazinon, prodhon, përpunon, tregon, blen, shet ose merret me çdo mënyre a mjet tjetër me produkte bujqësore. Të ushtrorë aktivitet në fushën e përpunimit, ambalazhimit, marketimit dhe tregëtimit të produkteve blegtorale, bujqësore, shtazore dhe të gjitha derivateve të tyre dhe të kryejë çdo veprim tjetër që lidhet me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin në fushën e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tërësi, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

**4.3 Hotel.**

**4.4 Market**

### **Neni 5**

Kohëzgjatja.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërise është 10.000 lekë.

Kapitali i mësipërn është nënshkruar dhe do të shlyhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë tërësisht në të holla nga " ortakët e shoqërisë " i shoqërisë.

"Fondacioni", është zotëruese i 1 kuote me vlerë 10.000 lekë, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblese së Ortakut së shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

#### Neni 8

Transferimi i kapitalit.

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) shitblerjes;
  - b) trashëgimisë;
  - c) dhurimit;
- cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.  
Personi që kalon kuoten dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyre solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit të kuotave, deri në castin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723. datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".  
Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.  
Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 9

Organi Vendimmarrës.

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimnarrës i shoqërisë.  
Asambleja e Ortakut është organi vendimarrës i shoqërisë që mirraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut. vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve.
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoreve, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve,
- f) miratimin e rregullave procedurave të mbledhjeve të asamblese,

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve,
- c) investime,
- k) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim. Përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



## **Neni 10**

### **Administrimi.**

Administratori i shoqërisë është: **Z. Arbër Hajdari**

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 (pese) vjecar me të drejtë ripertëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asambleja e Ortakut të shoqërisë.

Administrator mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

## **Neni 11**

### **Kompetencat.**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- k) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoje përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe në rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë. që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem e të jashtëzakonshem. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve

doganore, perfshi këtu edhe autoritetet gjyqesore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në perputhje me objektin e tij. Shoqëria nuk merr përsiper pasojat ndaj të treteve kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i Administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretet nuk mund ta injoronin këto akt në rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## **Neni 12**

### **Përgjegjësitë.**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marreveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marreveshjen, për të perballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të vecante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vleresoje me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim,
- y) të parandaloje dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare. Me përjashtim të rasteve kur, në bazë të betimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t' i dëmshpërblejë shoqërisë demet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t' i kalojë çdo fitim personal që ata apo personal e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administratori, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

**Neni 16**

Dispozita përfundimtare.

Ky Akt themelimi dhe statut i shoqërise "AGROTURIZEM NDRYSHE " shpk u redaktua me vullnet të lire e të plotë të "ortakeve themelues" ne 2 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE

**Fondacioni "Fundjavë Ndryshe"**

përfaqësuar nga Dr.Ekzekutiv

z.Arbër Hajdari

*Arbër Hajdari*

